



SHPALLJE E KONKURSIT PËR POZITËN

ANALIST PËR FINANCA DHE TARIFA

Departamenti:	Tarifa dhe Financa
Raporton te:	Udhëheqësi i Departamentit të Tarifave
Vendi i punës:	Prishtine
Niveli i pagës:	530 euro
Orari i punës:	I Plotë
Kontrata:	Një vjeçare me mundësi vazhdimi

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I POZITËS

Analisti për Financa dhe Tarifa të Ujit është përgjegjës për grumbullimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave financiare të dorëzuara nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave ("Ofruesit e Shërbimeve") tek ZRRUM si dhe të dhënave nga inspektimet e bëra nga vendi i ngjarjes. Gjithashtu është përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve për tarifën e shërbimit të propozuara dhe të dorëzuara nga kompanitë e licencuara tek ZRRUM-i.

Për punën e vet Analisti për Financa dhe Tarifa të Ujit i jep përgjegjësi Udhëheqësit të Seksionit të Financave dhe Tarifave.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Participon aktivisht në shqyrtimin dhe amendamentimin e legjislacionit primar dhe akteve nënligjore që ka të bëjë me tarifën për shërbimet e ujit dhe mbeturinave;
- Participon aktivisht në zhvillimin e modeleve tarifore;
- Shqyrton aplikacionet e tarifave për të siguruar nëse parimet e përgjithshme të paraqitura në Rregullën mbi Tarifa janë respektuar dhe tarifën e shërbimit janë llogaritur sipas kërkesave të kësaj Rregulle;
- Bën analizat e të dhënave të dorëzuara ose të grumbulluara nga Ofruesit e Shërbimeve për të konfirmuar saktësinë e shënimeve për të hyrat dhe shpenzimet;
- Analizon Planet e Biznesit të Ofruesve të Shërbimeve dhe raporton te Mbikëqyrësi për rezultatet e analizave të kryera duke dhënë konkluzione dhe rekomandime përkatëse;
- Përcjellë dhe analizon efektet e zbatueshmërisë së tarifave të aprovuara nga ZRRUM në afarizmin ekonomik dhe financiar të Ofruesve të Shërbimeve;
- Shqyrton raportet financiare të Ofruesve të Shërbimeve të dorëzuara tek ZRRUM;
- Shqyrton shpenzimet operative dhe treguesit kyç financiar të Ofruesve të Shërbimeve dhe bënë krahasimin e tyre me nivelin e sektorit të ujit respektivisht mbeturinave;
- Shqyrton parametrat komercial të Ofruesve të Shërbimeve siç janë: arkëtimi dhe faturimi, dhe llogaritë e arkëtueshme të pa-mbledhshme;
- Kryen inspektime tek Ofruesit e Shërbimeve me qëllim të verifikimit të të dhënave dhe treguesve financiar të tyre dhe për këtë përpilon raporte me gjetjet dhe rekomandimet;
- Rregullisht përcjellë dhe informohet për udhëzimet dhe rekomandimet të lëshuara nga autoritetet kompetente lidhur me: (i) tatimet në fuqi siç janë: TVSH, tatimi mbi fitim, tatimi mbi pronën etj., (ii) standardet e reja të kontabilitetit të lëshuara nga autoritetet kompetente të cilat rregullojnë çështjet siç janë: shpenzimet e lejueshme, amortizimi i mjeteve themelore fikse, borxhet e këqija, ndihmat financiare nga qeveria, etj, si dhe (iii) legjislacionin e miratuar nga autoritetet kompetente lidhur me financat publike dhe implikimet që ka ky legjislacion në punën e ZRRUM;
- Kryen edhe punë tjera sipas nevojës së ZRRUM-it dhe kur kjo të kërkohet nga eprorët e tij të drejtpërdrejt.

KUALIFIKIMET

- Diploma Universitare në Fakultetin Ekonomikë, drejtimet e Kontabilitetit ose të Financave
- Së paku 3 vjet përvojë e punës profesionale në fushat relevante;
- Aftësi të theksuara analitike;
- Njohuri mbi administratën e institucioneve të Kosovës;
- Njohuri të punës në të folur dhe të shkruar të gjuhëve që janë në përdorim zyrtar në Kosovë;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter duke përfshirë Word dhe punën me tabela në Excel;
- Aftësi për të punuar nën presion;
- Aftësi për punë ekipore;
-

DATA E FUNDIT PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE: 22 MARS 2010

Formulari për aplikim mund të merret pranë Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur duke shkruar mbi të titullin e Postit në adresën e poshtë shënuar:

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Rr. Ferat Dragaj, 68, Bregu i Diellit Prishtinë (prapa furrës Qerimi 1)

Tel. +381 38 249 165 110;112 www.wwro-ks.org

DO TË KONTAKTOHEN VETËM KANDIDATËT QË HYJNË NË LISTEN E NGUSHTË